



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Kryesia e Kuvendit

P-006

Prishtinë, më 4 mars 2011, në orën 15:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 4 MARS 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletiç dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit;

Nga Grupet Parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Ibrahim Makolli, Sasha Rashiq dhe Rasim Demiri.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Xheladin Hoxha, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe
NDI: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë:

R e n d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 28 shkurt 2011,
2. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e dymbëdhjetë (12) komisioneve parlamentare,
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 28 shkurt 2011

Kryesia miratoi pa vërejtje Procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 28 shkurt 2011.

2. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e dymbëdhjetë (12) komisioneve parlamentare

Kryetari i njoftoi nënkryetarët e Kuvendit dhe kryetarët e grupeve parlamentare me Propozimin dhe kriteret për formimin e komisioneve parlamentare.

Lidhur me propozimin për formimin e komisioneve parlamentare të Legjislaturës IV, përkatësisht për: emërtimin, numrin, strukturën, kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit e tyre, diskutuan: Xhavit Haliti, Ibrahim Makolli, Ardian Gjini, Visar Ymeri, Sabri Hamiti, Ismet Beqiri, Rasim Demiri, Petar Miletqi dhe Enis Kervan. Diskutimet e tyre të plota janë dhënë në Transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kryesia vendosi që Kuvendit t'i paraqet këtë:

P R O P O Z I M - V E N D I M **për formimin e 13 (trembëdhjetë) komisioneve parlamentare**

Formohen 4 (katër) komisione të përhershme, sipas emërimit, në vijim:

I. Komisioni për Buxhet dhe Financa, 11 anëtarë,

1. GP PDK, kryetar,
2. GP LDK, zëvendëskryetar i parë,

3. GP SLS, zëvendëskryetar i dytë,

II. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, 12 anëtarë,

1. SLS, kryetar,
2. KKR, zëvendëskryetar i parë,
3. 6+, zëvendëskryetar i dytë,

III. Komisioni për Legjislacion, 11 anëtarë dhe

Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit,
nga radhët e anëtarëve të Komisionit,

1. GP LDK, kryetar,
2. GP PDK, zëvendëskryetar i parë,
3. GP 6+, zëvendëskryetar i dytë,

IV. Komisioni për Integritet Evropian, 9 anëtarë.

1. GP LDK, kryetar,
2. GP PDK, zëvendëskryetar i parë,
3. GP SLS, zëvendëskryetar i dytë,

II. Formohen 9 (nëntë) komisione funksionale, sipas emërimit në vijim:

I. Komisioni për Punë të Jashtme, 9 anëtarë,

1. GP VV, kryetar,
2. GP PDK, zëvendëskryetar i parë,
3. GP 6+, zëvendëskryetar i dytë,

II. Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, 11 anëtarë,

1. GP PDK, kryetar,
2. GP LDK, zëvendëskryetar i parë,
3. GP SLS, zëvendëskryetar i dytë,

III. Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, 11 anëtarë,

1. GP PDK, kryetar,
2. GP LDK, zëvendëskryetar i parë,
3. GP 6+, zëvendëskryetar i dytë,

IV. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, 9 anëtarë,

1. GP 6+, kryetar,
2. GP AAK, zëvendëskryetar i parë,
3. GP SLS, zëvendëskryetar i dytë,

V. Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor, 9 anëtarë,

1. GP PDK, kryetar,
2. GP VV, zëvendëskryetar i parë,
3. GP 6+, zëvendëskryetar i dytë,

VI. Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, 9 anëtarë,

1. GP AAK, kryetar,
2. GP VV, zëvendëskryetar i parë,
3. GP SLS, zëvendëskryetar i dytë,

VII. Komisioni për Mbikëqyrje të Agjensionit Kosovar për Inteligjencë, 9 anëtarë,

1. GP VV, kryetar,
2. GP PDK, zëvendëskryetar i parë,
3. GP SLS, zëvendëskryetar i dytë,

VIII. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, 9 anëtarë dhe

1. GP LDK, kryetar,
2. GP PDK, zëvendëskryetar i parë,

3. GP 6+, zëvendëskryetar i dytë,

IX. Komisioni për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, 9 anëtarë,

1. GP KKR, kryetar,

2. GP LDK, zëvendëskryetar i parë,

3. GP SLS, zëvendëskryetar i dytë.

Kryesia, gjithashtu, lidhur me këtë pikë nxori edhe këtë

P Ë R F U N D I M

1. Miratohet propozimi për themelimin e trembëdhjetë (13) komisioneve parlamentare për Legjislaturën IV, katër (4) komisione parlamentare të përhershme dhe nëntë (9) komisione funksionale.
2. Kryesia kërkon nga grupet parlamentare që, deri të martën, më 8 mars 2011, t'i propozojnë kandidatët për kryesues, zëvendëskryesues dhe anëtarë të komisioneve parlamentare, para se Propozim-vendimi të procedohet në mbledhjen plenare, më 10 mars 2011, për miratim.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.